



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 899/ Prot.
13

Tiranë, më 18.06.2021

VENDIM

Nr. 106, datë 18.06.2021

PËR

MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
ME QËNDRËN SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TERESA”

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, neni 3, pika 4, gërma “c” si dhe në Statutin e Universitetin të Sporteve të Tiranës neni 20, pika “s”, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 18/06/2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Teresa”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA





QËNDRA SPITALORE UNIVERSITARE
"NËNË TEREZA"

UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Nr. _____ prot.
Tiranë, më _____. 2021

Nr. _____ prot.
Tiranë, më _____. 2021

DRAFT MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Lidhur sot me datë __/__/2021, në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", midis palëve si më poshtë:

- **QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"**, institucion publik me strukturë shëndetësore universitare të përgjithshme, me NIPT J61911023A dhe seli në adresën: Rruga e Dibrës, Nr. 372, Tiranë, e-mail: QSUT@shendetesia.gov.al, përfaqësuar ligjërisht nga Drejtori i Përgjithshëm **Z. Enkelejdi Joti**, më poshtë referuar si "QSUNT";

dhe

- **UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**, institucion publik i arsimit të lartë i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 123 datë 17.02.2010 dhe seli në Adresën Rruga "Muhamed Gjollësja", Tiranë, e-mail: contact@ust.edu.al, përfaqësuar për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje nga Rektori **Prof.Dr. Agron KASA** (këtu e me poshtë referuar "UST");

Ky Memorandum Bashkëpunimi lidhet mbështetur në Ligjin Nr. 7850 datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH", si dhe Statutin e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë me nr. 5842 prot., datë 10.10.2018 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe nr.10762/1 prot, datë 30.10.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Palët bien dakord për sa më poshtë:

1. Ky memorandum bashkëpunimi ka si qëllim ofrimin e shërbimeve të ndërmjetëm me interes të përbashkët dhe lehtësimin e marrëdhënieve ndër institucionale në kuadër të bashkërendimit të aktiviteteve ndërmjet palëve.

15. Mosmarrëveshjet midis Palëve, për këtë Memorandum do të zgjidhen me negocim, në të kundërt do të quhet Memorandum i përfunduar dhe i zgjidhur.

**QËNDRA SPITALORE UNIVERSITARE
“NËNË TEREZA”**

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Z. Enkelejdi JOTI

**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË
TIRANËS**

REKTORI

Prof.Dr. Agron KASA